



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova



KOSOVA DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM
Address: Dëshmorët e Lirisë - nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org

Kultivimi i Arrës më ngritjen e Pemishtës të re



Hyrje

Arrëra (Juglans regia) është një kulturë me vlerë të lartë ekonomike dhe agronomike, e përshtatshme për shumë zona klimatike, përfshirë edhe Kosovën. Për të siguruar një prodhim të lartë dhe cilësor, është e rëndësishme të ndjekësh hapa të kujdesshëm gjatë ngritjes së pemishtes dhe mirëmbajtjes së saj. Hapat kryesorë për ngritjen e një pemishteje të re me arra:

1. Zgjedhja e vendndodhjes

Arrat preferojnë toka pjellore, të thella dhe me drenazh të mirë. Duhet të shmangen tokat me ujë të ndenjur ose shumë të rënda. Klima duhet të jetë e përshtatshme, me temperatura të buta dimërore dhe pa rreziqe të larta të ngricave pranverore.

2. Përgatitja e tokës

Kryhet analiza e tokës për të përcaktuar përmbajtjen e lëndëve ushqyese dhe pH-në (mesatarja 6-7 ph). Nëse është e nevojshme, bëhet gëlqerëzimi ose plehërimi organik dhe kimik për të përmirësuar pjellorinë. Thellësia e lërimit duhet të jetë 50-60 cm për të siguruar zhvillim të mirë të rrënjëve.

3. Përzgjedhja e fidanëve dhe kultivarëve

Zgjidhen kultivarë të përshtatshëm në Kosovë dhe me produktivitet të lartë janë Chandler dhe Franquette. Fidanët duhet të jenë të shëndetshëm dhe të certifikuar, të mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

4. Skema e mbjelljes

Distanca e mbjelljes varet nga lloji/kultivari, por zakonisht sillet nga 6x5m, 5x5 m deri në 5x4m. Hapja e gropave duhet të bëhet të paktën 50 cm thellësia x50 cm gjerësia x 50 gjatësia cm, duke shtuar pleh organik dhe ujitje të parë pas mbjelljes. Mbjellja e pemishtes duhet të jetë domosdoshme me dy lloje Chandler dhe Franquette për shkak nevojës së domosdoshme të polenizimit.

5. Kujdesi dhe mirëmbajtja

Ujitja është e nevojshme sidomos në vitet e para të rritjes.

Plehërimi duhet të përmbajë azot (N), fosfor (P), kalium (K) sipas nevojave të bimës.

Krasitja duhet të bëhet për të formësuar me ekspert si dhe për të nxitur prodhimin.

Monitorimi duhet të bëhet për mbrojtjen ndaj dëmtuesve, sëmundjeve dhe bakteret.

6. Vjelja dhe ruajtja

Frutat janë të gatshme për vjelje kur lëvozhga fillon të çahet vetvetiu/natyrale. Tharja e arrës zgjat 7-10 ditë, derisa arrat të kenë lagështi nën 10%. Pas tharjes, ruajtja duhet të bëhet në ambiente të ajrosura dhe me lagështi të kontrolluar apo frigorifer me temperaturë nga 0-4°C.



Foto 1: Arra në dy forma

Arra më së miri rritet/kultivohet në zonat me klimë të butë kontinentale, me verëra të ngrohta dhe dimra të butë. Arra preferon shumë dritë diellore

Prodhimtaria e arrës - varet nga shumë faktorë, duke përfshirë llojin e arrës, kushtet klimatike, cilësinë e tokës, sistemin e menaxhimit dhe kujdesin agronomik. Aspektet kryesore që ndikojnë në rendimentin dhe cilësinë e prodhimit të arrës:

1. Faza e frutdhënësë dhe rendimenti

- ✓ Arrat fillojnë të japin fruta pas 4-6 vjetësh nga mbjellja (në varësi të kultivarit dhe metodës së kultivimit).
- ✓ Prodhimtaria maksimale arrihet pas 10-15 vjetësh.
- ✓ Rendimenti mesatar për një pemë të pjekur arrihet nga 20-40 kg arra të thata (për pemë) ose 3-5 tonë/ha në varësi të dendësisë së mbjelljes dhe kushteve të kultivimit.
- ✓ Kultivarët modernë si Chandler dhe Franquette kanë prodhim më të lartë, janë përshtatur në kushtet e Kosovës dhe japin fruta më mira për konsumatorët.

2. Faktorët që ndikojnë në prodhim

Zgjedhja e kultivarit - Disa varietete kanë rendiment më të lartë dhe përshtatje më të mirë ndaj klimës lokale. Në Kosovë lloji i arrës Chandler dhe Franquette janë më frytdhënës dhe më të përshtatshme për prodhim.

Klima dhe temperaturat - Temperaturat ekstreme (ngricat pranverore ose thatësira e verës) mund të ndikojnë negativisht në prodhim, prandaj është e nevojshme sistemi i ujitjes të jetë funksional.

Toka - Të thella, pjellore dhe me drenazh të mirë.

Ujitja - Është e nevojshme dhe të jetë funksional, veçanërisht e rëndësishme në periudhën e rritjes, formimit të frutave dhe kur ka thatësira.

Plehërimi - Aplikimi i plehrave të duhura rrit produktivitetin dhe duhet të behet në kohën e duhur dhe sipas këshillave të eksperteve.

Mbrojtja nga dëmtuesit dhe sëmundjet - Bakteret dhe dëmtuesit mund të ulin ndjeshëm prodhimin nëse nuk trajtohen me kohë.



Fotot: Faza e lulëzimit, rritjes, pjekjes dhe vjelljes së arrës

Varietetet (lloji) e arrës, duhet të përzgjidhen sipas kushteve klimatike të tokës, vendit të mbjelljes/kultivimit si dhe për tregun e synuar

Koha më e rekomanduar për mbjelljen e arrës është Vjeshta (tetor - dhjetor) për arsyeje:

- ✓ Fidanët e mbjella në vjeshtë kanë më shumë kohë për t'u përshtatur me tokën dhe zhvillojnë rrënjë më shpejt.
- ✓ Përfitojnë nga lagështia natyrore e dimrit, duke reduktuar nevojën për ujitje në pranverë.

- ✓ Fillojnë rritjen më herët në pranverë dhe janë më rezistentë ndaj thatësisirës verore.
- ✓ Duhet të shmanget mbjellja shumë e vonë nëse ka rrezik nga ngricat e forta.



Foto 3: Modeli se si do të duhet një plantacion me arrë

Koha e dytë që mundet të mbillet arra është në pranvera (shkurt - prill):

- ✓ Fidanët janë më pak të ekspozuar ndaj ngricave dimërore.
- ✓ Mbjellja në pranverë është e përshtatshme në zonat me dimra të fortë.
- ✓ Ujitja është e domosdoshme në muajt e parë të mbjelljes, sidomos nëse pranvera është e thatë.
- ✓ Fidanët mund të kenë një start më të ngadaltë në krahasim me ata të mbjella në vjeshtë.

Këshilla për mbjelljen - Mbjellja e arrës kërkon kujdes të veçantë për të siguruar një rritje të mirë dhe një prodhim të lartë në vitet e ardhshme.

- ✓ Mbillni fidanë me rrënjë të zhveshura në periudha kur pema është në gjumë vegjetativ.
- ✓ Përgatitni gropat (50x50x50 cm ose më shumë deri 70 cm) të paktën 2-3 javë përpara mbjelljes dhe pasuroni tokën me pleh organik (pleh i stallës).

Zgjedhja e kultivarit të arrës sipas llojit të tokës - Duhet të bëhet në bazë të kushteve të tokës dhe klimës në zonën ku do të mbillen fidanët. Disa varietete janë më të përshtatshme për toka pjellore dhe të thella, ndërsa të tjera mund të përshtaten edhe me toka më të varfra.

1. Kultivarë për toka pjellore dhe të thella, më të mirat për prodhim të lartë janë:

a). Lloji i arrës Chandler

- ✓ Kultivari më i njohur dhe më produktiv (jep fruta cilësore dhe me shije që kërkon tregu).
- ✓ Kërkon toka të pasura me lëndë ushqyese dhe drenazh të mirë.
- ✓ Jep prodhim të lartë dhe ka bërthamë cilësore me përmbajtje të lartë vajore.
- ✓ Rekomandohet të mbillet zonat me temperatura mesatare dhe dimra të butë.



Foto 4: Arra Chandler

Arra Chandler - Është njëra prej fidanëve që jep më së shumti prodhim. Nga pamja e jashtme është me lëvore të hollë, pak e palëmuar dhe në formë ovale. Lehtë thehet dhe nxirret nga lëvozhga. Në moshën 7-9 vjeçare një trup prodhon 25-40 kg fruta/arra. Në moshën 10-19 vjeçare një trup Chandler prodhon përafërsisht 50-70 kg fruta/arra. Nga 20 vjet një trup mund të arrijë prodhimtarinë deri në 80 kg fruta/arra, në kushtet më të mira të kultivimit. Në pranverë lulëzon me vonesë prandaj nuk ndikohet nga ngricat e vonshme pranverore. Mund të mbjellët në hapësirat ku lartësia mbidetare arrin deri në 1200 metra. Origjina e kësaj arre është SHBA. Madhësia e frutit të kësaj arre me lëvozhgë është 40-42 milimetra. Peshë me lëvozhgë është 12-14 gram. Peshë e brendshme për konsum është 6-8 gram. Polenizuesi për këtë lloj arre është Franquette, Fernett

Gjatë ndërtimit të pemishtes së arrës, duhet të jetë e domosdoshme sasia e nevojshme e ujit, më së miri nevojitet sistemi ujtës me pika për të kursyer ujin dhe për të rritur efikasitetin e shpenzimeve dhe prodhimit

b). Lloji i arrës Franquette

- ✓ E përshtatshme për klima më të freskëta dhe tokë pjellore me drenazh të mirë.
- ✓ Ka rezistencë më të lartë ndaj ngricave pranverore.
- ✓ Prodhimi është mesatar, por arrat janë të mëdha dhe cilësore.



Foto 4: Arra Franquette

Arra Franquette - Në një tufëz mund zhvillohen 2-3 fruta. Lëvozhga është e hollë. Thehet lehtë dhe ndahet lehtë nga lëvozhga. Është e përshtatshme mbjellja e këtij lloji deri në 1200 metra lartësi mbidetare. Origjina e kësaj arre është Franca. Madhësia e fruit me lëvozhgë është 42-43 milimetra. Peshë me lëvozhgë është 11,5 gram. Peshë e brendshme është 5,5 gram. Polenizuesi i kësaj arre është Chandler, Pedro

2. Llojet e tjera të arrës për toka mesatare ose më të varfra, me të përshtatshëm janë:

a). Lloji i arrës Lara - Rezistent ndaj kushteve mesatare të tokës. Jep prodhim të mirë edhe në toka më të thata ose mesatarisht pjellore. Ka rritje të shpejtë dhe fillon prodhimin herët.

b). Lloji i arrës Elit - Përshtatet me kushte të ndryshme të tokës dhe është më rezistent ndaj sëmundjeve. Mund të rritet edhe në toka me pjellori mesatare. Jep prodhim të qëndrueshëm me cilësi të mirë të frutave.

3. Llojet e arrës për toka të rënda dhe me drenazh të dobët, me të përshtatshëm janë:

a). Lloji i arrës Fernor - Rritet mirë edhe në toka me drenazh mesatar ose më të rënda. Është rezistent ndaj ngricave dhe ka prodhim të mirë. Ka një shtrirje të gjerë të përshtatshmërisë klimatike.

b). Lloji i arrës Geisenheim 139 - I përshtatshëm për toka më të lagështa ose të rënda. Ka rezistencë të lartë ndaj sëmundjeve dhe kushteve të vështira klimatike.

Arra Chandler është një ndër varietetet më të njohura dhe të kultivuara në botë për shkak të rendimentit të lartë dhe cilësisë së frutave. Fermerët e rinj rekomandohet që të mbjellin këtë lloj arre, pasi që është veçanërisht e përshtatshme për pemishtet komerciale dhe menaxhohet lehtë me masa agroteknike dhe moderne bujqësore

Normat e mjaftueshme të elementeve ushqyese për arrën - Për të siguruar një rritje të shëndetshme dhe një prodhim të lartë, arrat kanë nevojë për një furnizim të ekuilibruar të elementeve ushqyese. Doza e nevojshme e plehrave varet nga tipi i tokës, mosha e pemëve dhe niveli i prodhimit.

Ushqimi i arrës me elementet kryesore për kultivimin dhe prodhimin e arrës:

- ✓ Azoti (N) - Stimulon rritjen vegetative dhe të frutit.
- ✓ Fosfori (P) - Thelbësor për zhvillimin e rrënjëve dhe lulëzimin.
- ✓ Kaliumi (K) - Përmirëson cilësinë e frutave dhe rrit qëndrueshmërinë e pemës.

Normat e nevojshme për një pemishte të rritur (kg/ha në vit)

Elementi	Doza (kg/ha)	Përdorimi sipas periudhës
Azoti (N)	100 - 200	50% në pranverë, 50% pas lulëzimit
Fosfori (P)	40 - 80	Në dimër ose fillim pranvere
Kaliumi (K)	150 - 250	Në dimër ose fillim pranvere

Kujdes: Dozat mund të përshtaten sipas analizës së tokës dhe këshillave të eksperteve.

Ushqimi i arrës me elementet shtesë sipas nevojës dhe këshillave të eksperteve për kultivimin dhe prodhimin e arrës mund të behet edhe plehra të tjera:

- ✓ Zinku (Zn) - Ndikon në zhvillimin e sythave dhe përmirëson prodhimin.
- ✓ Bori (B) - I rëndësishëm për formimin e frutave dhe lulëzimin.
- ✓ Magnezi (Mg) - Përmirëson fotosintezën dhe cilësinë e arrave.

Normat e nevojshme për një pemishte të rritur (kg/ha në vit)

Elementi	Doza (g/pemë)	Mënyra e aplikimit
Zink (Zn)	50 - 100	Spërkatje në pranverë
Bor (B)	20 - 50	Spërkatje para lulëzimit
Magnez (Mg)	100 - 150	Pleh i tretshëm ose blatë

Rekomandime për aplikimin e plehrave

- ✓ Nëse toka është e varfër me azot, përdorni ure (46% N) ose sulfat amoni (21% N).
- ✓ Nëse toka ka mungesë fosfori, përdorini superfosfat të thjeshtë (20% P_2O_5).
- ✓ Nëse ka mungesë kaliumi, përdorni sulfat kaliumi (50% K_2O) për cilësi më të mirë të frutave.
- ✓ Për tokat acidike, duhet të shtohen gëlqere ($CaCO_3$) për të balancuar pH-në.

Cilin kultivar duhet të zgjedh për mbjellje?

- ✓ Nëse toka juaj është e pasur dhe e thellë duhet të mbjellin llojin e arrës Chandler, Franquette.
- ✓ Nëse toka është mesatare duhet të mbjellin llojin e arrës Lara, Elit, Serr.
- ✓ Nëse toka është e rëndë ose me drenazh të dobët duhet të mbjellin llojin e arrës Fernor, Geisenheim 139.

Para mbjelljes, bëni një analizë të tokës për të përcaktuar cilësinë e saj dhe zgjidhni kultivarin më të përshtatshëm

Përfundimet

Kultivimi i arrës është një investim afatgjatë që kërkon kujdes të vazhdueshëm, por nëse zbatohet siç duhet, mund të jetë shumë fitimprurës. Bazuar në praktikat më të mira, mund të nxjerrim disa përfundime kryesore:



Kultivimi i arrës është një aktivitet me potencial të madh ekonomik dhe ekologjik.



Me kujdesin e duhur në mbjellje, plehërim, ujitje dhe mbrojtje, mund të arrini prodhim të lartë dhe cilësor për shumë vite me radhë.



Me një treg të qëndrueshëm për produktet e arrës, ky kultivim mund të sigurojë të ardhura të konsiderueshme.



Për më shumë informata ju lutem kontaktoni:

MBPZHR- Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike

Rr. "Ukshin Hoti" ndërtesa "Ramiz Sadiku", Nr.120

10000 Prishtinë

Tel : +383 38212338 ; +383 200 38 426

Tel/ fax: +383212 987

Kjo broshurë është përgatitur nga KDC, me Projektin "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes avancimit të Shërbimeve Këshillimore", të financuar nga MBPZHR. Përgjegjësinë për përmbajtjen e broshurave e mban KDC.



**KOSOVO DEVELOPMENT CENTER
QENDRA KOSOVARE PËR ZHVILLIM**

Address: Dëshmoret e Lirisë nr.135 Gjakovë-Kosovë
Tel: +383 38 724 499 Email: kdc.gjakov@yahoo.com
www.kdc-ks.org